

URDHËR
Nr. 1090, datë 3.11.2025

**PËR DELEGIMIN E KOMPETENCËS SË MINISTRIT PËR EVROPËN DHE
PUNËT E JASHTME MBI ÇËSHTJET KONSULLORE**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 22 e vijues, të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”; ligjin nr. 8372, datë 9.7.1998, “Për ushtrimin e funksioneve konsullore nga Përfaqësitë Diplomatike ose Konsullore”, ligjin nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe drejtorit të Drejtorisë së Çështjeve Konsullore sipas përcaktimeve të këtij urdhri.

2. Drejtorit të Drejtorisë së Çështjeve Konsullore i delegohet kompetenca për ndjekjen dhe nënshkrimin e shkresave si më poshtë:

a) përcjellje e akteve të gjendjes civile, lejeve të drejtimit, pasaportave e sendeve të humbura, specimene të dokumenteve shqiptare apo të huaja;

b) verifikim dokumentacioni të lëshuar nga institucionet shqiptare:

- për identitetin e shtetasit shqiptarë,

- për figurën e kandidatit për konsuj nderi të RSH-së dhe të huaj;

c) kërkesat për çelje-mbyllje aksesesh për diplomatët, operatorët tek Identitek, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë;

d) shkresat shoqëruese për postën diplomatike që përmban pasaporta dhe materiale të Identitek-ut;

e) përcjellje praktikash për heqjen dhe rifitimin e shtetësisë shqiptare;

f) përcjellje kërkesash për ekstradim, ndihmë juridike, ndalim, arrestim për shtetas shqiptar e të huaj.

3. Sekretarit të Përgjithshëm i delegohet kompetenca për nënshkrimin e të gjithë akteve të tjera me karakter konsullor, që nuk përfshihen në pikën 2 të këtij urdhri.

4. Njoftimet dhe komunikimet elektronike për çështjet konsullore i drejtohen drejtorit të Drejtorisë së Çështjeve Konsullore, duke vënë në dijeni Sekretarin e Përgjithshëm.

5. Të gjitha njoftimet/publikimet e aktiviteteve/njoftimeve konsullore në faqet apo llogaritë zyrtare të rrjeteve sociale të MEPJ-së, si dhe të misioneve diplomatike/posteve konsullore të RSH-së bëhen me miratimin e Sekretarit të Përgjithshëm, me propozim të Drejtorisë së Çështjeve Konsullore, në bashkëpunim me kabinetin e ministrit.

6. Titullarët e misioneve diplomatike dhe posteve konsullore të Republikës së Shqipërisë i raportojnë për veprimtarinë konsullore, në bazë ditore, drejtorit të drejtorisë që i mbulon çështjet konsullore.

7. Drejtori i drejtorisë që mbulon çështjet konsullore i raporton, në bazë ditore, veprimtarinë konsullore, të ushtruar nga përfaqësitë/postet konsullore, Sekretarit të Përgjithshëm.

8. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, drejtori i Drejtorisë së Çështjeve Konsullore, titullarët dhe punonjësit konsullorë në misionet diplomatike dhe postet konsullore të RSH-së, si dhe drejtorja e Sekretarisë dhe Komunikimit Qendror.

9. Ky urdhër i njoftohet strukturave të ngarkuara dhe misionëve diplomatike e konsullore nga Sektori i Menaxhimit të Dokumentacionit në Drejtorinë e Sekretarisë dhe Komunikimit Qendror.

10. Urdhri nr. 311, datë 3.5.2024, “Për delegimin e kompetencës për trajtimin e çështjeve konsullore”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

Elisa Spiropali